

HARTËZIMI I PRIORITETEVE TË HULUMTIMIT MBI EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM NË BALLKANIN PERËNDIMOR | 2019



DISA FAKTE

- Mes kërcënimit në rritje të ekstremizmit të dhunshëm (EDH) në të gjithë botën, vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida të mëdha në kohezionin dhe stabilitetin social.
- Është e nevojshme të kuptohen më mirë grupet e ekstremit të djathtë dhe ato etnonacionaliste, lidhja e tyre me konfliktet e mëparshme dhe dinamika sociale, ndikimi i tyre në dinamikat lokale dhe lidhjet e tyre me aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë.
- Me një fokus të shtuar ndaj dinamikave të ekstremizmit të dhunshëm në nivel individual, korrupsioni mund të jetë një faktor i paparashikuar dhe i paeksploruar që kontribuon në ekstremizmin e dhunshëm dhe më gjerë në pasigurinë shtetërore dhe atë sociale.
- Politikëbërësit dhe ekspertët e fushës në Ballkanin Perëndimor po kërkojnë të kuptojnë më mirë se si i tërheqin të rinjtë grupet ekstremiste të dhunshme.
- Kuptimi më i thellë i ekosistemeve të kapitalit shoqëror dhe politik brenda komuniteteve që rrisin qëndrueshmërinë ose ndjeshmërinë e tyre ndaj ekstremizmit të dhunshëm është jetike për politikëbërësit dhe ekspertët e fushës që punojnë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivelin e komunitetit.
- Nevojitet më shumë hulumtim mbi vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë riatdhesuar ose ndjekur penalisht shtetas të cilët janë kthyer nga konflikte ekstremiste të dhunshme jashtë vendit, për të kuptuar më mirë efikasitetin e përgjigjeve të tyre dhe për të informuar përpjekjet e përbashkëta të riatdhesimit dhe riintegritit në të ardhmen.

Konteksti

Mes kërcënimit në rritje të ekstremizmit të dhunshëm (EDH) në të gjithë botën, vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida të mëdha në kohezionin dhe stabilitetin social. Si kudo tjetër, narrativat e militantizmit fetar, të ekstremit të djathtë dhe nacionalist përkojnë me popullatat e cënueshme të të rinjve në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku një histori konfliktesh etnike, fetare dhe civile ka krijuar një situatë cënueshmërie ndaj rekrutimit nga terroristët brenda dhe jashtë vendit. Personat që kanë shkuar për të luftuar përkrah organizatave ekstremiste të dhunshme jashtë vendit po kthehen në vendet e tyre pas humbjeve territoriale të grupeve ekstremiste në Siri dhe Irak. Në të njëjtën kohë, ekstremizmi etnonacionalist vazhdon të fitojë terren dhe të zgjerohet në të gjithë rajonin.¹

Ndërkohë që disa prej këtyre temave kanë marrë vëmendje të shtuar në tërësinë e literaturës aktuale,² të tjera tema mbeten të nënhulumtuara. Çështjet ekzistuese të hulumtimit kërkojnë gjithashtu më shumë studime në terren dhe baza më të thella konceptuale. Boshllëqet që rezultojnë në të kuptuarit tonë kolektiv janë tregues të nevojës për hulumtime të mëtejshme mbi zhvillimin e dinamikave sociale dhe të EDH në Ballkanin Perëndimor. Një hulumtim më rigoroz dhe i bazuar në këtë drejtim mund të ndihmojë në informimin dhe përmirësimin e përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në rajon (prevent and counter violent extremism, P/CVE).

Në vitin 2019, rrjeti “RESOLVE” mbledhi ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë për të diskutuar boshllëqet kërkimore dhe për të hartuar një listë paraprake të prioriteteve kërkimore për të çuar përpara parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor.³ Çështjet e identifikuar më poshtë pasqyrojnë ekspertizën e tyre të përbashkët, kuptimin e thellë dhe angazhimin për analizë të vazhdueshme të tendencave dhe dinamikave të EDH në rajon.

Grupet e Ekstremist të Djathtë në Ballkanin Perëndimor

Si zhvillohen dinamikat e ekstremizmit të djathtë dhe etnonacionaliste në Ballkanin Perëndimor dhe si lidhen ato me rrjetet ndërkombëtare?

Në përgjigje të vëmendjes politike dhe programatike në rritje ndaj individëve nga Ballkani Perëndimor që shkuan në Irak dhe Siri, literatura mbi radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në rajon është përqendruar kryesisht në radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm islamik.⁴ Ndërkohë që një sërë hulumtimesh dhe analizash janë botuar mbi llojet e tjera të ekstremizmit

1 Leonie Vrugman, “Future Challenges of Violent Extremism in the Western Balkans” (Sfidat e ardhshme të ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor) *Institute for Democracy and Mediation*, 2019, <https://idmalbania.org/future-challenges-of-violent-extremism-in-the-western-balkans-february-2019/>

2 Shpend Kursani, “Extremism Research Forum. Literature Review 2017-2018: Violent Extremism in the Western Balkans,” (Ekstremizmi i dhunshëm në Ballkanin Perëndimor) *British Council*, shkurt 2019, https://www.britishcouncil.al/sites/default/files/20fnl20kursani_literature20review20ii20-20erf.pdf.

3 Nga të dy mbledhjet, e para u organizua në bashkëpunim me “Forum MNE” dhe “Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë” (QKSS) në Podgoricë, Mali i Zi, në prill 2019. Mbledhja e dytë u mbajt gjatë Forumit për Qëndrueshmërinë e Ballkanit Perëndimor të organizuar nga “International Republican Institute” në Sofje, Bullgari, në dhjetor 2019. Dy grupet e pjesëmarrësve përfshinin hulumtues, ekspertë të politikave dhe ekspertë të fushës nga Shqipëria, Bosnja, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Pjesëmarrës të tjerë nga Bullgaria morën pjesë në diskutime gjatë forumit të Sofjes.

4 Shpend Kursani, “Extremism Research Forum.”

të pranishëm në rajon,⁵ ekziston një hendek i madh në të kuptuarit e dinamikës së ekstremizmit të djathtë dhe etnonacionalizmit. Anëtarët e grupeve të punës diskutuan nevojën për një kuptim më të madh të grupeve të ekstremit të djathtë dhe etnonacionaliste; lidhjen e tyre me konfliktet e mëparshme dhe dinamikat sociale, veçanërisht në vitet 1990; ndikimin e tyre në dinamikat lokale, institucionet demokratike dhe politikë; si dhe lidhjet e tyre me aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë. U ngritën pyetjet e mëposhtme si çështje kryesore për t'u shqyrtuar më tej në hulumtime, me qëllim orientimin e politikave dhe praktikës:

- Cila është panorama aktuale e grupeve të ekstremit të djathtë dhe etnonacionaliste në Ballkanin Perëndimor? Në ç'masë janë të lidhura me njëra-tjetrën këto grupe dhe në ç'masë ndikojnë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor?
- Çfarë diskursi dhe narrativash përdorin grupet ekstremiste të ekstremit të djathtë në Ballkanin Perëndimor?
 - Deri në ç'masë trashëgimia e konfliktit në rajon kontribuon në narrativat e ekstremit të djathtë dhe nxit ksenofobinë?
 - Deri në ç'masë e kanë përdorur narrativat e ekstremit të djathtë në rajon dinamikën ndërkombëtare - përfshirë imigracionin nga Lindja e Mesme, Afrika dhe gjetkë dhe proceset dhe diskutimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian - dhe si e kanë përdorur atë?
- Si u përgjigjen llojet e tjera të grupeve dhe narrativave ekstremiste diskursit dhe grupeve të ekstremit të djathtë dhe anasjelltas?
- Si ndërveprojnë me njëri-tjetrin grupet e ekstremit të djathtë në Ballkanin Perëndimor?
- Si kanë ndikuar narrativat dhe grupet e ekstremit të djathtë në pikëpamjet dhe besimin në vlerat demokratike?
- A janë të lidhura grupet e ekstremit të djathtë në Ballkanin Perëndimor me partitë politike ose strukturat ekzistuese të pushtetit?
- Si ndikon ideologjia ekstremiste e ekstremit të djathtë në politikat shtetërore?
- Si i janë përgjigjur qeveritë ekstremizmit të djathtë në rajon? Çfarë ndikimi ka pasur kjo në përhapjen apo vazhdimin e tij?
- Si ndikojnë fuqitë e huaja në grupet e ekstremit të djathtë në Ballkanin Perëndimor?

5 Luke Kelly, "Overview of research on far right extremism in the Western Balkans," (Përmbledhje e hulumtimeve mbi ekstremizmin e djathtë në Ballkanin Perëndimor) K4D Helpdesk Report, 2019, Brighton, UK: Institute of Development Studies, https://assets.publishing.service.gov.uk/media/5d309f7aed915d2fe9ea6aec/620_Western_Balkans_far_Right.pdf. Shembuj të literaturës mbi llojet e tjera të ekstremizmit të pranishëm në rajon përfshijnë: Marina Lažetić, "'Migration Crisis' and the Far Right Networks in Europe: A Case Study of Serbia" (Kriza e migrimit dhe rrjetet e ekstremizmit të djathtë në Evropë: Një rast studimor për Serbinë) *Journal of Regional Security* 13, 2018, <https://doi.org/10.5937/jrs13-19429>; Marija Đorić, *Ekstremna desnica: međunarodni aspekti desnicaškog ekstremizma* (Right Wing Extremism: International Aspects of Right Wing Extremism) (Belgrade: (Aspektet ndërkombëtare të ekestermizmit të djathtë) (Beograd: Udruženje Nauka i društvo Srbije, 2014); Valery Perry, *Extremism and Violent Extremism in Serbia: 21st (Ekstremizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm në Serbi: Manifestimet e shekullit të 21-të dhe sfidat historike*, (Ibidem, 2019); Marija Đorić, *Hooliganism: Extremism, Violence and Sports (Huliganizmi: Ekstremizmi, dhuna dhe sportet* (Serbia: Society of Science, 2012); Aleksandar R. Ivanovic, "Traditional Forms of Radicalism and Violent Extremism in the Western Balkans as the Main Challenge to Stability" (Format tradicionale të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor si sfida kryesore e stabilitetit) *Securitologia* 1, 2018, https://www.academia.edu/38249643/Traditional_Forms_of_Radicalism_and_Violent_Extremism_in_the_Western_Balkans_as_the_Main_Challenge_to_Stability

Rekrutimi i të rinjve

A janë të rinjtë një popullatë e cenueshme ndaj rekrutimeve të ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor?

Politikëbërësit dhe ekspertët e fushës në Ballkanin Perëndimor po kërkojnë të kuptojnë më mirë se si i tërheqin të rinjtë grupet ekstremiste të dhunshme. Angazhimi i të rinjve është një gur themeli i shumë prej projekteve të përqendruara në parandalimin e këtij fenomeni në rajon që synojnë të fuqizojnë të rinjtë ose të rrisin ndërgjegjësimin e tyre mbi shenjat e radikalizimit.⁶ Hulumtimet ekzistuese mbi këtë temë shqyrtojnë radikalizimin dhe rekrutimin e të rinjve të Ballkanit Perëndimor sipas çdo vendi. Sidoqoftë, nevojitet një kuptim më në hollësi i të rinjve si një demografi shumëplanëshe dhe i mënyrave në të cilat grupet ekstremiste të dhunshme kërkojnë të shfrytëzojnë ose angazhojnë popullata të ndryshme të të rinjve, për të ndikuar në hartimin dhe zbatimin efektiv të programit të parandalimit. Do të duhet një lente gjithëpërfshirëse gjinore që përfshin analizën e masklizmit dhe feminizmit, si dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe moshës për të kuptuar nuancat e rekrutimit të të rinjve në të gjithë rajonin.

Pjesëmarrësit sugjeruan kryerjen e studimeve fillestare për të përfshirë njohuri gjithëpërfshirëse rreth të rinjve dhe radikalizimit në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Pyetjet e mëposhtme u shtruan si çështje kryesore për hulumtime të mëtejshme për të ndikuar mbi politikën dhe praktikën:

- Si i tërheqin, radikalizojnë, rekrutojnë dhe mobilizojnë llojet e ndryshme të grupeve ekstremiste të dhunshme të rinjtë në Ballkanin Perëndimor? A ndryshon kjo sipas vendit?
 - Kush janë audiencat e synuara të këtyre grupeve midis popullatave të të rinjve?
 - Çfarë narrativash përdorin ato që tërheqin të rinjtë?
 - Çfarë metodash apo mjetesh përdorin ato për të tërhequr të rinjtë?
- Cila është ndarja demografike - gjinia, mosha, etj. - e të rinjve që u bashkohen llojeve të ndryshme të grupeve ekstremiste të dhunshme?
- Cili është roli i gjinisë në rekrutimin, radikalizimin dhe mobilizimin e të rinjve?
- Deri në çfarë mase disponueshmëria dhe lloji i arsimit, punësimit dhe mundësive për rritje të lëvizshmërisë sociale në rajon i bën të rinjtë në rajon më të cenueshëm ose më pak të cenueshëm për t'u rekrutuar?
- Deri në çfarë mase ndikon trashëgimia e konfliktit etnik në rajon tek të rinjtë sot? A ndikojnë ende narrativat etnonacionaliste dhe të viktimizimit nga konfliktet e mëparshme tek të rinjtë në vendet e Ballkanit Perëndimor?
- Deri në çfarë mase ndikon emigracioni i të rinjve dhe “largimi i trurit” (emigrimi i individëve të talentuar dhe të arsimuar drejt vendeve të tjera në kërkim të mundësive më të mira të punësimit dhe jetesës) në dinamikën sociale dhe të ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan?
- Si i kuptojnë dhe i shohin të rinjtë narrativat dhe grupet ekstremiste të dhunshme në rajon?

6 Eric Rosand, “Civil Society Organizations in Preventing and Countering Violent Extremism in the Western Balkans—Mapping Report,” (Organizatrat e shoqërisë civile për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor- Raporti i Hartëzimit) *Forum MNE*, dhjetor 2018, https://organizingagainstve.org/wp-content/uploads/2019/02/regional_report.pdf.

Kapja e Shtetit, Korrupsioni dhe Radikalizimi

Cila është marrëdhënia midis korrupsionit dhe radikalizimit në ekstremizmin e dhunshëm?

Me një fokus të shtuar ndaj dinamikave të ekstremizmit të dhunshëm në nivel individual, korrupsioni mund të jetë një faktor i paparashikuar dhe i paeksploruar që kontribuon në ekstremizmin e dhunshëm dhe më gjerë në sigurinë shtetërore dhe atë sociale. Disa teori e eksplorojnë korrupsionin si një kërcënim për sigurinë dhe stabilitetin global, duke treguar se si korrupsioni dhe kleptokracia qeveritare mund t'i çojnë popullatat e dëmtuara në ekstreme.⁷ Pjesëmarrësit vunë në dukje rëndësinë e studimit të kapjes së shtetit— korrupsionit që përfshin partneritet midis aktorëve politikë dhe individëve nga sektori i biznesit, të cilët përdorin proceset politike për të manipuluar shpërndarjen e burimeve shtetërore dhe median për të ecur përpara me axhendat e tyre—për të kuptuar më mirë dinamikën e vazhdueshme në lidhje me dhunën dhe paqëndrueshmërinë në Ballkanin Perëndimor.

Pjesëmarrësit identifikuan se kapja e shtetit krijon në mënyrë të pashmangshme ankesa dhe dobësi. Në Ballkanin Perëndimor të pas konfliktit, ku qasjet ndaj politikës të bazuara tek të drejtat dhe juridiksioni mbeten të dobëta dhe shpërndarja e burimeve shihet kryesisht politike, pjesëmarrësit parashtruan teorinë se praktikatat e kapjes së shtetit mund të ndikojnë shumë në dinamikën dhe tendencat e radikalizimit. Sidoqoftë, lidhja midis kapjes së shtetit dhe radikalizimit në rajon mbetet e pastudiuar. Kjo është veçanërisht shqetësuese nëse kemi parasysh diskutimet e në rajon që sugjerojnë lidhje të mundshme midis elitave politike dhe aktorëve ekstremistë.

Pjesëmarrësit sugjeruan që për të mbushur këtë boshllëk kërkimor të kryhen kërkime ndër-krahasuese të rasteve studimore për të studiuar më tej shkallën e kapjes së shtetit dhe lidhjet e tij me ekstremizmin e dhunshëm në rajon. Pyetjet e mëposhtme u shtruan si çështje kryesore për hulumtime të mëtejshme për të ndikuar mbi politikën dhe praktikën:

- Cila është marrëdhënia midis korrupsionit dhe radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor?
- Si ka ndikuar korrupsioni në perceptimet e qytetarëve për qeveritë e tyre dhe aftësinë e qeverisë së tyre për të qeverisur dhe ofruar shërbime? A ka ndikuar kjo në këndvështrimet apo shfaqjen e formave alternative të qeverisjes?
- Çfarë ndikimi kanë sektorët e dëmtuar dhe të politizuar të drejtësisë në kultivimin e ndjenjës së ankesës?
- Cila është marrëdhënia midis elitave politike, institucioneve fetare dhe grupeve ekstremiste të dhunshme në Ballkanin Perëndimor?
 - Si manifestohen këto marrëdhënie (p.sh. sistemet e patronazhit, masat që lidhen me sigurinë dhe kontrollin etj.)?
 - Si inkurajohen, mbështeten dhe nxiten këto lidhje?
- Si ndikojnë lidhjet e perceptuara midis aktorëve dhe ekstremistëve politikë dhe narrativave në status quo-në dhe praktikatat e tjetërsimit etnik, racor dhe/ose fetar në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor?

⁷ Sarah Chayes, *Thieves of State: Why Corruption Threatens Global Security (Hajdutët e shtetit: Përse e kërcënon korrupsioni sigurinë globale)* (New York: Norton, 2015)

- Cila është marrëdhënia midis korrupsionit dhe radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm? Si kontribuon korrupsioni në radikalizim dhe si e përdorin politikanët radikalizimin për të justifikuar korrupsionin?
- Si e përdorin politikanët radikalizimin për të justifikuar veprimtaritë e tyre? A ndikon apo përkon kjo me shpërndarjen selektive të burimeve dhe qasjen në strukturat qeverisëse brenda shoqërive të Ballkanit Perëndimor?

Qëndrueshmëria e Komunitetit

Cilat aspekte brenda komuniteteve të Ballkanit Perëndimor i bëjnë ato më të qëndrueshme, më pak të qëndrueshme apo të ndjeshme ndaj nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm?

Brishtësia ekonomike dhe shoqërore në vendet e Ballkanit Perëndimor pas konfliktit—ashtu si në vendet jashtë rajonit—i ka lënë shtetet dhe komunitetet të cenueshme nga faktorët e jashtëm të paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë.⁸ Hulumtimet ekzistuese, megjithëse të kufizuara, shqyrtojnë qëndrueshmërinë ndaj ekstremizmit të dhunshëm në nivel rajonal dhe vendor, duke gjurmuar marrëdhëniet ndërmjet mbështetjes për ekstremizmin e dhunshëm etnonacionalist ose të bazuar në Irak/Siri dhe nxitësve të ndryshëm të cenueshmërisë dhe qëndrueshmërisë. Ky hulumtim përfshin analizën e perceptimeve të margjinalizimit, dëshirën për stabilitet dhe agjenci, urbanizimin, praninë në internet, fuqizimin e grave, arsimimin, statusin martesor, punësimin, identitetin fetar dhe etnik dhe traumën e kaluar nga VE.⁹ Pavarësisht njohurive të bollshme ekzistuese, pjesëmarrësit theksuan hendekun e mbetur në kuptimin e këtyre dinamikave në nivelin hiperlokal.

Anëtarët e grupit të punës sugjerojnë se është shumë e rëndësishme që politikëbërësit dhe ekspertët e fushës që punojnë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel komuniteti të kuptojnë më mirë ekosistemet e kapitalit social dhe politik brenda komuniteteve që rrisin qëndrueshmërinë ose ndjeshmërinë e tyre ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Pjesëmarrësit theksuan se përkufizimet e “i qëndrueshëm” dhe “i cenueshëm” nuk duhet të zbatohen për t’i përshkruar komunitetet si një i tërë—komunitetet mund dhe shfaqin njëkohësisht si dobësi, ashtu edhe qëndrueshmëri.

Më tej, ata theksuan se propaganda e ekstremizmit të dhunshëm në internet është studiuar gjerësisht në rajon dhe shpesh shpërfill ose neglizhon rolin e komunikimeve dhe aktiviteteve përtej internetit në përhapjen e propagandës dhe narrativave të ekstremizmit të dhunshëm në nivel komuniteti. Ata gjithashtu parashtruan nevojën për hulumtime të mëtejshme mbi angazhimin e aktorëve fetarë në përpjekjet për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, duke theksuar se ndërsa aktorët fetarë mund të jenë të dobishëm në lehtësimin e diskutimeve me popullata të caktuara brenda një komuniteti, në komunitete të tjera ata nuk shihen gjithmonë me të njëjtin legjitimitet dhe besueshmëri (më së shumti tek të rinjtë). Pjesëmarrësit parashtruan nevojën për hulumtime të mëtejshme lidhur me ndikimin që ka familja, arsimi dhe aktivitetet jashtëshkollore në nxitjen e qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj aktorëve dhe retorikës së ekstremizmit të dhunshëm. Pjesëmarrës të tjerë përmendën se tendencat e emigracionit mund të shënojnë apo ndikojnë në nivelin e qëndrueshmërisë apo cenueshmërisë së komunitetit ndaj ndikimit të ekstremizmit të dhunshëm.

8 Sabina Lange, Zoran Nechev, and Florian Trauner, “Resilience in the Western Balkans,” (Qëndrueshmëria në Ballkanin Perëndimor) *EU Institute for Security Studies*, 2017, https://www.ies.be/files/Report_36_Resilience%20in%20the%20Western%20Balkans_0.pdf.

9 Atlantic Initiative, “Countering Violent Extremism Baseline Program Research Findings—Bosnia & Herzegovina,” December 2018, (Gjetjet e hulumtimit mbi luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm - Bosnje-Hercegovinë, dhjetor 2018). <http://atlantskainicijativa.org/wp-content/uploads/CVE-Baseline-Research-Findings-December-2018.pdf>.

Pyetjet e mëposhtme u shtruan si çështje kryesore për hulumtime të mëtejshme për të ndikuar mbi politikën dhe praktikën:

- A kanë organizatat e shoqërisë civile mjete dhe burime për të lehtësuar diskutimet dhe ndërgjegjësimin mbi radikalizimin me prindërit, edukatorët dhe anëtarët e tjerë me ndikim në komunitet që angazhohen me të rinjtë?
- Cilat struktura sociale mund t'i pengojnë diskutimet në lidhje me kuptimin e mëtejshëm të ekstremizmit të dhunshëm brenda komuniteteve të ndryshme të Ballkanit? Si ndikojnë këto struktura sociale, shoqëruar me trashëgiminë e vjetër të mosbesimit dhe ndarjet sociale me bazë identiteti, në qëndrueshmërinë dhe cenueshmërinë në nivel lokal dhe në shkallë rajoni ose vendi?
- A ka lidhje (pozitive ose negative) midis decentralizimit të qeverisë dhe qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm? Cilat janë balancat midis përpjekjeve të centralizuara të qeverisë për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe përgjigjeve nga komuniteti ndaj ekstremizmit të dhunshëm?
- Si mund dhe si duhet t'i angazhojnë programet e parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm udhëheqësit fetarë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së komunitetit?
- A do të mundet aktivizmi qytetar në çështjet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm në nivel komuniteti të mbetet i qëndrueshëm, veçanërisht lidhur me çështjet e financimit dhe legjitimitetin e tyre të perceptuar?
- Në çfarë mase i adresojnë programet për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm ndarjet sociale? A kanë programet e tjera një rol në ndërtimin e paqes dhe forcimin e shoqërisë civile jashtë sferës së parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm?
- Si ndikon financimi ndërkombëtar në natyrën dhe perceptimet e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor?

Trauma dhe Shërbimet Psikosociale

Cili është roli i traumës së mëparshme në procesin e radikalizimit dhe si mund të ndihmojë në parandalimin e radikalizimit ofrimi i shërbimeve psikologjike të trajtimit të traumës pas konfliktit?

Pjesëmarrësit theksuan një interes në rritje për të hulumtuar lidhjen midis traumës dhe ekstremizmit të dhunshëm. Disa hulumtime sugjerojnë se ka lidhje të mundshme midis radikalizimit dhe traumës së kaluar.¹⁰ Sidoqoftë, nevojiten më shumë hulumtime për të kuptuar më mirë rolin e traumës—personale dhe kolektive—në radikalizimin, rekrutimin, shkëputjen dhe riintegrimin.

10 Pete Simi, Bryan Bubolz, Hillary McNeel, Karyn Sporer, and Steven Windisch, "Trauma as a Precursor to Violent Extremism: How non-ideological factors can influence joining an extremist group," (Trauma si pararendëse e ekstremizmit të dhunshëm: Si mund të ndikojnë faktorët joideologjikë në futjen në një grup ekstremist) *START*, prill 2015, https://www.start.umd.edu/pubs/START_CSTAB_TraumaAsPrecursortoViolentExtremism_April2015.pdf; Radicalisation Awareness Network, "A mental health approach to understanding violent extremism," RAC EX Post Paper, June 2019, (Rrjeti për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizimit: "Një qasje ndaj shëndetit mendor për të kuptuar ekstremizmin e dhunshëm", RAC EX Post Paper, qershor 2019) https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_hsc_prac_mental_health_03062019_en.pdf.

Kjo është e një rëndësie të veçantë në Ballkanin Perëndimor, një rajon që ka përjetuar konflikt të dhunshëm dhe luftëra kohët e fundit, që ka parë shtetas nga rajoni të shkonin për të jetuar dhe luftuar në territoret e kontrolluara nga organizatat terroriste në Irak dhe Siri dhe për të luftuar në Ukrainë, dhe ka mundësuar kthimin e qindra prej këtyre individëve përsëri në rajon.

Pjesëmarrësit theksuan se në të gjithë Ballkanin Perëndimor ekziston gjerësisht traumë, stigmë dhe ankesa të patrajuara që burojnë nga historia e konflikteve në rajon.¹¹ Vazhdon ende të ketë gjerësisht mungesë të ndihmës psikosociale për të trajtuar traumën e kaluar dhe atë aktuale. Pjesëmarrësit theksuan se nevojiten hulumtime të mëtejshme për të kuptuar se si trauma e zgjatur dhe e përhapur në shëndetin mendor, e lidhur me konfliktin në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor pas konfliktit—në mungesë të shërbimeve, mbështetjes dhe mekanizmave për ta adresuar atë—mund të çojë në sjellje shkatërruese dhe të dhunshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në ekstremizmin e dhunshëm. Hulumtime të mëtejshme mbi nivelet dhe ndikimin e traumës në Ballkanin Perëndimor do t'i ndihmonin ekspertët e fushës të hartonin programe parandaluese, ndërhyrëse dhe riintegrimi më të posaçme dhe të bazuara në informacion mbi traumën, të cilat adresojnë faktorët e nevojshëm psikologjikë dhe socialë.¹² Megjithatë, pjesëmarrësit vunë në dukje se ka pak interes, si në rajon dhe midis donatorëve ndërkombëtarë, për financimin e programeve psikosociale dhe të bazuara në informacion për traumën, veçanërisht përtej periudhës dymbëdhjetëmuajore të performancës së një donatori.

Pyetjet e mëposhtme u shtruan si çështje kryesore për hulumtime të mëtejshme për të ndikuar mbi politikën dhe praktikën:

- Cila është shkalla e traumës në komunitetet e Ballkanit Perëndimor dhe si ndikojnë nivelet e ndryshme të traumës në kohezionin dhe mirëqenien sociale në nivelin e familjes dhe të komunitetit?
- Si ndikon trauma nga luftërat e mëparshme, dhuna, zhvendosjet, migracioni etj., në nivelet e cenueshmërisë ndaj dhunës dhe radikalizimit në nivel individual?
- Si ndikon disponueshmëria dhe sigurimi i mbështetjes profesionale në cenueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e komuniteteve ndaj narrativave dhe aktorëve të ekstremizmit të dhunshëm?
- Cilat janë praktikat dhe dispozitat e dobishme psikosociale për të mbështetur individët në nevojë?
- Çfarë mund të mësohet nga vendet e tjera që kanë përjetuar lloje të ngjashme të konfliktit të dhunshëm shoqëror—si për Shërbull, Libani dhe Irlanda e Veriut—që mund të informojnë përvojat dhe programimin në lidhje me traumën dhe mbështetjen psikosociale në Ballkanin Perëndimor?

11 Maya E. Lee, "Practices and Perspectives on Mental Health in the Balkan Countries: A Narrative Review" (Praktikat dhe perspektivat mbi shëndetin mendor në vendet e Ballkanit: një shqyrtim historik) *Indiana University Journal of Undergraduate Research*, 5 no. 1 (September 2019) <https://doi.org/10.14434/iujur.v5i1.26876>.

12 Valerie De Marinis and Eolene Boyd-MacMillan, "A mental health approach to understanding violent extremism" (Një qasje ndaj shëndetit mendor për të kuptuar ekstremizmin e dhunshëm) *Qendra e Ekselencës RAN (RAN Centre of Excellence)*, 3 qershor, 2019 https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_hsc_prac_mental_health_03062019_en.pdf.

Të Kthyerit dhe Riintegrimi

Si ndikon konteksti specifik individual, komunitar ose i shtetit në efikasitetin e iniciativave për shkëputje nga ekstremizmi i dhunshëm dhe pajtim?

Çështja e luftëtarëve të huaj ka qenë një interes politik në Ballkanin Perëndimor që nga viti 2012. Më shumë se 1000 shtetas nga Ballkani Perëndimor udhëtuan drejt Irakut dhe Sirisë për të jetuar dhe luftuar në territoret e kontrolluara nga terroristët. Nuk ka shumë informacion publik mbi numrin e individëve që udhëtuan nga Ballkani Perëndimor për të luftuar në Ukrainë.

Sot, vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të hasin vështirësi në lidhje me mënyrën e trajtimit të atyre që janë kthyer ose dëshirojnë të kthehen nga këto zona konflikti. Disa vende në rajon nuk kanë ndërmarrë ende ndonjë hap konkret për riintegrimin ose për pranimin e kthimit të luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre. Në vendet e tjera me përvoja të ngjashme, strukturat e hershme dhe ekzistuese të mbështetjes së riintegrimit mbeten në mëshirën e disponimit të financimeve, burimeve dhe dinamikës në zhvillim lidhur me konfliktet ekstremiste të dhunshme jashtë vendit. Ndërkohë që ka burime në dispozicion të politikëbërësve dhe ekspertëve të fushës për të ndihmuar në hartimin dhe zbatimin e programeve të riintegrimit dhe përgjigjes së drejtësisë penale, pjesëmarrësit vunë në dukje se hulumtimet e mëtejshme duhet të synojnë praktikën më të mira për kontekste specifike individuale, komunitare dhe shtetërore në rajon. Për më tepër, pjesëmarrësit shprehën se nevojitet më shumë hulumtim mbi vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë riatdhesuar ose ndjekur penalisht shtetas të cilët janë kthyer nga konflikte ekstremiste të dhunshme jashtë vendit, për të kuptuar më mirë efikasitetin e përgjigjeve të tyre dhe për të informuar përpjekjet e ardhshme të riatdhesimit dhe riintegrimit. Pjesëmarrës të tjerë u shprehën se, nga të gjitha çështjet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm, riatdhesimi dhe riintegrimi shpesh mjaft i lokalizuar i luftëtarëve të huaj ka pasoja minimale për shumicën e qytetarëve të rajonit.

Pyetjet e mëposhtme u shtruan si çështje kryesore për hulumtime të mëtejshme për të ndikuar mbi politikën dhe praktikën:

- Cilat strategji të shkëputjes zbatohen aktualisht? A kanë rezultuar ato efektive?
- Cilat janë kushtet e nevojshme për të shkaktuar ndryshime të sjelljes dhe/ose njohjes të popullatave të radikalizuara dhe të dhunshme që kthehen nga konfliktet ekstremiste të dhunshme jashtë vendit?
- Çfarë dimë për deradikalizimin?
- Cilat janë dinamikat specifike, kodet ligjore dhe përvojat që duhet të merren parasysh gjatë riatdhesimit të të rinjve të kthyer?
- Cilat janë konsideratat specifike që duhet të merren parasysh në lidhje me të kthyerit që ndiqen penalisht dhe burgosen pas kthimit të tyre? Çfarë masash duhet të merren për të zbutur radikalizimin e mundshëm ose radikalizimin e mëtejshëm tek të kthyerit e futur në burg?
- Sa efektive dhe të qëndrueshme janë qasjet e shkëputjes dhe deradikalizimit të drejtësisë penale?
- Si ndryshojnë përgjigjet e drejtësisë penale në vendet e Ballkanit Perëndimor për personat që kthehen nga Iraku dhe Siria dhe për personat që kthehen nga Ukraina?

Rreth Serisë së Grupeve të Punës për Hartëzimin e Prioriteteve të Hulumtimit të “RESOLVE”

Grupet e punës për hartëzimin e prioriteteve të hulumtimit të “RESOLVE” synojnë të lehtësojnë zhvillimin e temave ose prioriteteve specifike gjeografike për studimin e ekstremizmit të dhunshëm bazuar në njohuritë dhe ekspertizën e ekspertëve, studiuesve dhe ekspertëve të fushës për P/CVE në rajon.

“RESOLVE” dëshiron të falënderojë anëtarët e grupit të punës, si dhe “Forum MNE”, Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Institutin Republikan Ndërkombëtar (IRI) për pjesëmarrjen, ekspertizën, komentet dhe mbështetjen e tyre. “RESOLVE” dëshiron gjithashtu të falënderojë “U.S. Department of State’s Bureau for Conflict and Stabilization Operations” për financimet bujare për këtë panoramë të prioriteteve, grupet e punës që e pasuruan atë me informacion dhe Iniciativën Kërkimore të Ballkanit Perëndimor të “RESOLVE”.

Panoramat e prioriteteve të hulumtimit të “RESOLVE” informohen nga anëtarët e grupeve të punës dhe pasqyrojnë njohuritë, ekspertizën dhe pikëpamjet e vetë anëtarëve. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e rrjetit “RESOLVE”, Institutit të Paqes të SHBA-ve ose ndonjë organi qeveritar të SHBA-ve.

Botuar në tetor 2020.

RESOLVE NETWORK

better research • informed practice • improved policy on violent extremism •

www.resolvenet.org



“RESOLVE” e ka selinë në Institutin e Paqes të SHBA-ve dhe mbështetet në trashëgiminë dhjetëra vjeçare të angazhimit të thellë të Institutit në komunitetet e përfshira nga konflikti.



**UNITED STATES
INSTITUTE OF PEACE**
Making Peace Possible